

# STATUT

## I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

### "SCHOOL OF ADVANCED LEARNING ALBANIA"

Tiranë

më

Sot, më datë 29.07.2019 unë i poshtëshënuarit:

**Z.Ermal Jauri**, shtetas shqiptar, i biri i Hysen dhe Tushe lindur më 28.01.1983 në Burrel Shqipëri dhe banues në Rrugën Muhamet Deliu, Pallati Merkaj, Sh1,K5,A5 Tiranë i identifikuar nga Karta e Identitetit me numër 032851785. në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" kemi vendosur të krijojmë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar "SCHOOL OF ADVANCED LEARNING ALBANIA" Shpk (më poshtë referuar si "Shoqëria"), duke nënshkruar këtë Statut.

#### Kapitulli I

#### EMRI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

##### Neni 1

##### Forma

1. Shoqëria "SCHOOL OF ADVANCED LEARNING ALBANIA" Shpk është themeluar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe aktiviteti i saj rregullohet me anë të këtij Statuti.
2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

##### Neni 2

##### Emri

1. Emri i Shoqërisë është "SCHOOL OF ADVANCED LEARNING ALBANIA" Shpk.

##### Neni 3

##### Objekti

Objekti i shoqërisë është:

3.1 Shoqëria ka për objekt të kryeje dhe të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet dhe bizneset që një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar mund të kryeje në bazë të legjislacionit Shqiptar dhe të huaj për ngritjen dhe funksionimin e qendrave të arsimit profesional, qendrave të certifikimit të zanateve të fituara nëpërmjet formimit dhe ose arsimit formal ose informal.

3.2 Të ngrejë, funksionojë dhe menaxhojë shkollat të arsimit profesional të mesëm dhe të lartë.

3.3 Të ngrejë, funksionojë dhe menaxhoje shkolla të arsimit para dhe pas universitar.

3.4 Të organizojë aktivitete akademike, profesionale dhe ose shkencore në bashkëpunim me institucione të tjera vendase apo të huaja të niveleve të ndryshme, si dhe të certifikojë aktivitetin e realizuar.

3.5 Të hartojë dhe organizojë programe edukimi të cdo niveli.

3.6 Të organizojë aktivitetë, konferenca dhe kërkime shkencore si dhe ti botojë ato.

3.7 Të botojë artikuj të ndryshëm akademik dhe jo akademik.

3.8 Të organizojë mësimin dhe certifikimin e gjuhëve të huaja sipas niveleve respektive të cdo gjuhe.

3.9 Të realizojë përkthimin e dokumentacioneve, literaturave, programeve mësimore etj në gjuhë të ndryshme etj...

3.10 Gjithashtu Shoqëria për të realizuar objektin dhe qëllimin e saj, mund të ndërmarrë dhe zhvillojë cdo lloj aktiviteti tregtar, financiar, promocional apo dorëzanës që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.

#### **Neni 4**

##### **Selia**


4.1 Selia previzore e Shoqërisë ndodhet në: Rruga "Myslym Shyri", P 47, Zyra 3/1, Tiranë, Kutia Postare 2991, Shqipëri. Adresa e përhershme do të caktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në një moment të dytë.

4.2 Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vëtëm) mund të vendosë të transferojë selinë e Shoqërisë në një vend tjetër, apo mund të vendosë hapjen e degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë kudo, brënda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 5**

##### **Kohëzgjatja**

5.1. Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar. Afati i aktivitetit të Shoqërisë fillin nga momenti i regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.



- 5.2. Shoqëria mund të përfundojë apo vihet në likuidim me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të vetëm) ose të mbyllet me akte ligjore.

## Kapitulli II

### KAPITALI I SHOQERISE

#### Neni 6

##### Kapitali

- 6.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe është përbërë nga një kuotë me vlerë minimale 100 000 (njëqind mijë).

#### Neni 7

##### Kuotat e kapitalit dhe zotërimi i tyre

- 7.1 Derdhja e kuotave të kapitalit themeltar është bërë në mënyrën e mëposhtme:

**Z. Ermal Jauri** ka derdhur në para shumën prej 100 000 (njëqind mijë) lekë.

- 7.2 Sipas kontributeve të cituara:

- **Z. Ermal Jauri** zotëron 1 kuotë të kapitalit, të barabarta me 100% (një qind përqind) të kapitalit.

#### Neni 8

##### Zmadhimi i kapitalit

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme (ortaku i vetëm) mund të rrisë pa kufi kapitalin e Shoqërisë.
- 8.2 Administratori njofton për regjistrim, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, vendimin për zmadhimin e kapitalit. Vendimi publikohet edhe në faqen e internetit të Shoqërisë.
- 8.3 Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

#### Neni 9

##### Zmadhimi i kapitalit me aktive të Shoqërisë

- 9.1 Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.

- 9.2 Pjesa e rezervave, që shkon përtej 1/10 së kapitalit të regjistruar, si dhe fitimet e pashpërndara mund të kalohen në kapitalin fillestar.
- 9.3 Rezervat dhe fitimi i pashpërndarë nuk mund të kalohen në kapitalin bazë, nëse bilanci i vitit paraardhës rezulton me humbje.
- 9.4 Pjesë e kapitalit mund të shtohet cdo investim që do të behët në të ardhmën në emër të shoqërisë qoftë në aspektin material apo kontraktual e shërbime.

#### **Neni 10**

#### **Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

- 10.1 Asambleja e përgjithshme ( ortaku i vetëm) mund të reduktojë kapitalin themeltar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të reduktohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 10.2 Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratorët. Ky vendim publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

#### **Neni 11**

Transferimi i kuotave të kapitalit dhe e drejta e parablerjes .Kuotat e kapitalit mund t'u transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht, vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme ( ortakut të vetëm).

#### **Neni 12**

#### **Pasojat e kalimit të kuotave**

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

### **Kapitulli III**

### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ADMINISTRIMI, KONTROLLI**

#### **Neni 13**

#### **Të drejtat dhe detyrimet**

Asambleja e Përgjithshme ( ortaku i vetëm) është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;

- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

#### **Neni 14**

##### **Administrimi**

14.1 Shoqëria administrohet nga Administratori. Funkcion i cili do të kryehet nga ortaku i vetëm **Z. Ermal Jauri**, për një mandat 5 vjeçar, nga data e regjistrimit në QKB deri më përfundim të 5 viteve kalendarike nga data e regjistrimit në QKB me të drejtë ripërtëritjeje.

14.2 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë Shoqërinë;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

#### **Neni 15**

##### **Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia**

Administratori detyrohet të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi.

Administratorët përgjigjen ndaj Shoqërisë për çdo veprim që vjen në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale.

#### **Kapitulli IV SHPËRNDARJA E FITIMIT**

##### **Neni 16 Shpërndarja e fitimeve**

16.1 Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

16.2 Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

#### **Kapitulli V PRISHJA E SHOQËRISË**

##### **Neni 17 Shkaqet e prishjes së shoqërisë**

Shoqëria prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) nëse nuk kryen veprimtari tregtare për dy vjet;
- d) me vendim të gjykatës;

##### **Dispozita Kalimtare**

##### **Neni 18**

Ky Statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe.

Lexuar, nënshkruar

**Ermal Jauri  
Administrator**

